
AKT THEMELIMI
i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“RENOVA BELGIE ALBANIA” SH.P.K.

Sot, me date 21.10.2024, regjistrohet shoqeria RENOVA BELGIE ALBANIA shpk me ortak te saj, Z. Ismet Ademi i datelindjes 10.01.1971 i pajisur me pasaporten belge me GA4857211.

Neni 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijojë Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “RENOVA BELGIE ALBANIA” Sh.p.k., me kapital themeltar 100 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne, Dajt, Tirane ne adresen: Muhamet Deliu, Pallati Besa G&T, Shk. 2, Ap. 14, Kati 3, Dajt

Ortak i kesaj shoqerie do te jete Ismet Ademi.

Shoqeria “RENOVA BELGIE ALBANIA” Sh.p.k., ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3



Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithë ortaket e saj.

Neni 4

Objekti i shoqerise : Investitor ne fushen e ndertimit. Punime te ndryshme ne fushen e ndertimit. Rikonstruksione dhe ndertime ndertesash, rruge, vepra arti etj.

Neni 5

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 000 leke te ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000 leke per kuote ku:

Ismet Ademi, zoteron 1 kuote me vlere 100 000 leke qe perfaqeson 100% te kapitalit.

Kapitali themelor eshte depozituar nga ortaku ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimet te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Biznesit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 7

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 8

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.



Neni 9

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

Neni 10

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

ORTAKU I SHOQERISE

Ismet Ademi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Ismet Ademi', written over a horizontal line.